



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1164/4 prot.

Datë: 07.05.2026

V E N D I M
Nr. 600/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik Aleksandër Harizi në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme

Ankimues:

Operatori ekonomik Aleksandër Harizi me Nipt. L91401023I dhe adresë Lagjja Fushas, Rruga Fushas - 1, Godine private nr.57, kodi postar 1035, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Tirana Parking.
Rruga “Ali Begeja”, Ndërtesa Nr. 16, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II.2. Në datën 16.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6545 dhe me nr. 1164/2026 prot., datë 16.04.2026, e operatorit ekonomik Aleksandër Harizi, për procedurën e mësipërme të prokurimit, me pretendimin se:

“ *Nga studimi i dokumentave standarte të tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, evidentojmë që ka shkelje procedurale dhe mangësi thelbësore në dokumentacionin e tenderit, të cilat e bejnë të pamundur ofertimin në kushtet aktuale në të cilën është hartuar kjo procedurë prokurimi. Nisur nga ky fakt, përmes kësaj ankese po ushtrojmë të drejtën tonë për ankim në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar.*

. Nisur nga ky fakt, përmes kësaj ankese po ushtrojmë të drejtën tonë për ankim në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar.

Përmes sistemit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik jemi njohur me procedurën e hapur të thjeshtuar të Autoritetit Kontraktor Tirana Parking sha, me objekt “Mirëmbajtje e software të sistemit të parkimit”, numër reference REF- 81270-04-08-2026, dhe fond limit 2,460,000 lekë pa TVSH. .

Nga studimi i dokumentave standarte të tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, evidentojmë që ka shkelje procedurale dhe mangësi thelbësore në dokumentacionin e tenderit, të cilat e bejnë të pamundur ofertimin në kushtet aktuale në të cilën është hartuar kjo procedurë prokurimi. Nisur nga ky fakt, përmes kësaj ankese po ushtrojmë të drejtën tonë për ankim në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar.

Konkretisht kundërshtojmë përcaktimet në dokumentat e tenderit dhe kërkesat për kualifikim, si vijon:

1. *”2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023,2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me*

raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

2. “2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 1 (një) ose më shumë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si më poshtë, i cili të plotësojë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE”
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimeve “AD.EL Srl”
- 1 (një) specialist i certifikuar për konfigurime ne server
- 1 (një) specialist i certifikuar për të administruar databaza

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

? Certifikatat /Transkriptet perkatese të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.

? CV e punonjësit.

? Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

3. “2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8; Shërbime për manaxhimin e vendeve të parkimit 98351000-8.

4. “Shtojca 7: Shërbimet që kërkohen: Mirëmbajtje e kanalizimeve, puseta, pompave si më poshtë”

5. Operatori ekonomik i interesuar duhet të paraqesë vërtetimin që software i përfitësuar është i fiskalizuar në përputhje me Vendimin Nr.239, datë 20.03.2020 “Për Kërkesat Teknike dhe Funksionale të Zgjidhjes Software-ike për Proedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Proedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit Nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit?”.

6. “Shtojca 8 “Termet e References”, të detajuara si në vijim të kësaj ankese.....”

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresat dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.230/11 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1164/1 prot., datë 04.05.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi”p.f. mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e softëareve të sistemit të

parkimit” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kthimin e përgjigjes që autoritetit kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik ankimues mbi bazën e vendimit të KSHA-së që ka trajtuar këtë ankesë. Referuar kësaj shkrese rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj duke pranuar kriteret si më poshtë vijon:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në dokumentat standarte të tenderit, në pikën “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)” është përcaktuar “Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8: Shërbime për manaxhimin e vendeve të oarkimit 98351000-8”.

KSHA gjykon se kodi i përcaktuar nga AK ka të bëjë me paketat software dhe sistemet e informacionit, dhe është vendosur duke patur në konsideratë objektin e procedurës së prokurimit, si dhe termat e referencës së saj. Përcaktimi i kodit nuk është një element që përjashton apo ndalon një operator ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, pasi çdo operator ekonomik i interesuar, është i lirë të jetë ofertues në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht kodit CPV, i cili është një element që nuk ndikon, apo penalizon asnjë operator ekonomik të interesuar për pjesëmarrje dhe për të dhënë ofrën e tij.

Referuar pikës 10, të nenit 4 të Ligjit Nr.1 62/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se: “Fjalori i përbashkët i prokurimit” është sistemi unik klasifikues i nomenklaturave të mallrave, shërbimeve dhe punëve që aplikohet në procedurat për prokurime publike dhe që siguron njetrajtshmëri me nomenklaturat ekzistuese për mallra, shërbime dhe punë”.

Megjithatë KSHA, në shqyrtim të pretendimin të operatorit ekonomik konstaton se kodet e përdorura në dokumentet e tenderit përfaqësojnë kategori të përgjithshme dhe aktivitete që lidhen pjesërisht me objektin e prokurimit, por nuk e reflektojnë plotësisht natyrën specifike të shërbimit që synohet të kontraktohet. Në këtë kuptim, pa e konsideruar këtë si një parregullsi thelbësore, vlerësohet se një përcaktim më i detajuar dhe më i përshtatshëm i kodeve FPP do të kontribuonte në një identifikim më të qartë të objektit dhe në lehtësimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë që ushtrojnë aktivitete në këtë fushë. Në përputhje të sa më sipër, dhe në funksion të përmirësimit të qartësisë dhe përputhshmërisë së dokumenteve të tenderit me kërkesat ligjore, autoriteti kontraktor do të rishikojë kodet e përcaktuara dhe aty ku është e nevojshme, t'i përafrojë ato me kode më specifike të FPP që lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksander Harizi” p.f. qëndron..

- Nisur nga mungesa e përcaktimit të qartë të dokumentit të kërkuar si dhe për të qenë më të qartë të gjithë palët e përfshira në një proces prokurimi si operatorët ekonomikë që përgatisin ofertat, Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave si dhe Komisioni i Shqyrtimit të

Ankesave (në rastin e ankesave për vlerësimin), autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit, duke përcaktuar qartë dokumentin që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbujten e pikës 2.3(6) të “Kapacitetit teknik”.

Sa më lartë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në dokumentat standarte të tenderit, në Shtojcën 7, “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*” në pikën “Shërbimi që kërkohet” është përcaktuar “Mirëmbajtja e kanalizimeve, pusetave, pompave si më poshtë: ”.

Në shqyrtim të këtij pretendimi, KSHA gjykon se nga verifikimi i dokumenteve të tenderit konstatohet se në Shtojcën 7 është përfshirë formulimi “Mirëmbajtje e kanalizimeve. Pusetave, pompave si më poshtë”, i cili nuk lidhet me objektin konkret të prokurimit dhe nuk është në përputhje me natyrën e shërbimeve të kërkuara në këtë procedurë.

Në referim të nenit 36, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë dhe të saktë karakteristikat e shërbimeve që prokurohen, me qëllim shmangien e paqartësive dhe garantimin e një kuptimi të drejtë nga të gjithë operatorit ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, formulimi i sipërcituar vlerësohet si një pasaktësi e karakterit teknik-redaktues (lapsus), e cila nuk reflekton qëllimin real të autoritetit kontraktor dhe as objektin e procedurës.

Pa e konsideruar këtë si një devijim thelbësor të përmbajtjes së dokumenteve të tenderit, por për të qene të qartë dhe korrekt në hartimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit, ky formulim do të hiqet dhe do të korrigjohet në përputhje me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksander Harizi” p.f. qëndron.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në Shtojcën 9, në Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 2.3.4 është përcaktuar: “2.3.4 Operatori ekonomik i interesuar duhet të paraqesë vërtetimin që software i përditësuar është i fiskalizuar në përputhje me Vendimin Nr.239, datë 20.03.2020 “Për Kërkesat Teknike dhe Funksionale të Zgjidhjes Software-ike për Proçedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Proçedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit Nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit...” ” Gjithashtu në DST, në pikën 5.2 të Seksionit “Njoftimi i Kontratës; Autoriteti Kontraktor” është përcaktuar: “Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.”.*

Si dhe, ne Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit është përcaktuar si vijon:

“Certifikimi i sistemit:

Sistemi fiskalizimit i ofruar nga operatori duhet të jetë, para fillimit të shërbimit:

- *I certifikuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe AKSHI si zgjidhje software-ike e fiskalizimit, në zbatim të VKM Nr. 239, datë 20.03.2020 dhe rregullores së përbashkët të certifikimit me Drejtorinë e Pergjithshme të Tatimeve dhe AKSHI.*
- *I listuar në regjistrin zyrtar të subjekteve të certikuara të publikuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve në faqen zyrtare www.tatime.gov.al.*

Tirana Parking sh.a. do të jetë përgjegjëse për marrjen dhe rinovimin në kohë të certifikatës elektronike nga AKSHI, nëpërmjet portalit e-Albania, e cila do të përdoret nga Sistemi i fiskalizimit për nënshkrimin dixhital të faturave. Certifikata elektronike është e lidhur në mënyrë unike me Tirana Parking sh.a. si entitet dhe mund të përdoret për të gjitha pikat e fiskalizimit të kompanisë. Operatori i shërbimit do të asistojë Tirana Parking sh.a. në procesin e konfigurimit të certifikatës në sistem ”.

Në shqyrtim të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit mbi software-in e fiskalizimit, konstatohet se në dokumentet e tenderit kjo është është trajtuar në disa seksione të ndryshme, konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, në informacionet shpesh, si dhe në shtojcën përkatëse mbi specifikimet teknike.

Referuar nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor ka detyrimin që kriteret e kualifikimit dhe kërkesat për dokumentacionin provues të përcaktohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe shprehur në dokumentet e tenderit, në mënyrë që operatorit ekonomik të kenë mundësi të kuptojnë detyrimet e tyre dhe të përgatisin ofertat në përputhje me këto kërkesa.

Në rastin konkret, kërkesa për një software të fiskalizuar në përputhje me Vendimin Nr.239, datë 20.03.2020 dhe ligjin Nr. 87/2019 është në vetvete e ligjshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 kërkon në mënyrë të qartë që operatori ekonomik të vërtetojë se software-i është i fiskalizuar në përputhje me legjislacionin përkatës, ndërkohë që parashikimet e tjera në dokumentet e tenderit japin detaje shpesh mbi mënyrën e implementimit dhe përdorimit të këtij sistemi gjatë zbatimit të kontratës.

Përcaktimi në pikën 5.2 “Informacione shpesh” në dokumentat standarde të tenderit, është pjesë përbërëse standarde në DST dhe autoriteti kontraktor nuk ka asnjë kompetencë për ta ndryshuar apo hequr. KSHA gjykon se përcaktimet e mësipërme nuk bien ndesh me njëra tjetrën për atë kohë sa kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk çenojnë në thelb parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

Megjithatë mënyra e reflektimit të saj në tre seksione të ndryshme të dokumenteve të tenderit, me terminologji dhe nivele të ndryshme detajimi, mund të krijojë një situatë potencialisht konfuze për operatorët ekonomikë lidhur me natyrën dhe formën e dokumentacionit që duhet të paraqitet në fazën e ofertimit. Kjo mbivendosje nuk është një shkelje e dispozitave ligjore në thelb, por mund të kërkojë një strukturim më të qartë dhe koherent të kërkesave, në mënyrë që të shmangen interpretimet e ndryshme dhe të garantohet siguri juridike për pjesëmarrësit në procedurë.

Në këto kushte, dhe në funksion të rritjes së qartësisë, transparencës dhe lehtësisë të pjesëmarës në procedurë, KSHA vlerëson të arsyeshme rishikimin e dokumenteve të tenderit për të unifikuar dhe saktësuar kërkesat në fjalë, duke i përmbledhur ato në mënyrë të qartë në seksionin përkatës.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f. qëndron.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 8 të Dokumentave Standarde të Tenderit, është përcaktuar si vijon:
Konkretisht versionet e **“Lince”** të cilët janë instaluar në sistemet e parkimit si më poshtë:
 1. Ish - Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë – (pranë “Asllan Rusi”)
 2. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (pranë Kompleksit “Malajzian”)
 3. Terminali i Autobuzave të Juglindjes – (pranë qendrës tregtare “TEG”)
 4. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”)
 5. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Pallati i Sportit “Asllan Rusi”)
 6. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).
 7. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Frederik Shopen”).
 8. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).
 9. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).
 10. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).
 11. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Bulevardi i Ri”)
 12. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Kopshti Zoologjik”)

KSHA konstaston se, Autoriteti Kontraktor ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka konstatuar se pasaktësia e evidentuar lidhet vetëm me emërtimin e një pike parkimi në dokumentacion, ridërkohë që gjendja faktike në terren dhe numri i pikave funksionale të marra në konsideratë në përlllogaritje janë në përputhje me sa është parashikuar në DST. Konkretisht, numri i pikave të parkimit të konsideruara në përlllogaritjen e fondit limit është i saktë dhe i bazuar në situatën reale të ofrimit të shërbimit, pavarësisht pasaktësisë në emërtim, e cila nuk ndikon në përmbajtjen dhe shtrijen e objektit të kontratës.

Gjithashtu, në lidhje me përllogaritjen e fondit limit, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor është bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat përcaktojnë se: “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit.

2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit të këtij ligji, përveç se kur kjo justifikohet nga arsye objektive”.

Në zbatim të nenit 34 të ligjit, vlera e parashikuar e kontratës (fondi limit) përllogaritet si një vlerë totale, e cila përfaqëson koston e plotë të shërbimit për të gjithë periudhën e kontratës, bazuar në analiza tregu, eksperiencë të mëparshme, si dhe në kërkesat konkrete të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Ky nen nuk detyron Autoritetin Kontraktor që për çdo rast të përcaktojë çmime për njësi për çdo element të veçantë të shërbimit, përveç rasteve kur vetë natyra e kontratës e kërkon një gjë të tillë.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 36 të ligjit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë objektin e kontratës dhe kërkesat funksionale të shërbimit, por nuk imponojnë detyrimin për ndarjen e fondit limit në çmime për njësi, nëse kontrata është konceptuar si një shërbim i integruar.

Për rrjedhojë, në këtë procedurë përllogaritja e fondit limit është kiyer në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si një vlerë totale për realizimin e shërbimit në të gjitha pikat e parashikuara, dhe jo si çmime për njësi për çdo pikë individuale. Kjo qasje është në përputhje me natyrën e kontratës dhe nuk cenon konkurrencën apo barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Megjithatë, duke qenë se pasaktësia në emërtim mund të krijojë paqartësi në interpretimin e dokumentacionit nga operatorët ekonomikë, dhe me qëllim garantimin e një procesi plotësisht transparent dhe të qartë për të gjithë pjesëmarrësit, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me anulimin e procedurës së prokurimit, për të mundësuar korrigjimin dhe saktësimin e dokumentacionit përkatës. Pas reflektimit të këtyre saktësimeve, procedura do të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f qëndron.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, mbi përmbajtjen e Shtojcës 8 “Termat e Referencës”, ju bëjmë me dije se, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në dokumentacion kërkesat funksionale dhe objektin e kontratës në mënyrë të përgjithshme, duke synuar sigurimin e një sistemi funksional, të përditësuar dhe të integrueshëm me infrastrukturën ekzistuese të parkimit.

Referimi ndaj versioneve të ndryshme të “software”-it Lince lidhet me faktin se sistemet aktuale janë instaluar në periudha të ndryshme dhe, për rrjedhojë, nuk paraqesin një standard të unifikuar versioni. Për këtë arsye, nuk është përcaktuar një version specifik (si p.sh. 7.0), por është lënë hapësirë që operatorit ekonomik të propozojnë zgjidhje që përmbushin kërkesat për përditësim, siguri, performancë dhe integritet, në përputhje me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Sa i takon lidhjes me serverin multiparking, kjo është një kërkesë funksionale që lidhet me nevojën për menaxhim të centralizuar të sistemeve të parkimit, dhe detajimi teknik i saj është pjesë e zgjidhjes që duhet të ofrohet nga operatori ekonomik në kuadër të realizimit të kontratës.

Në lidhje me licencat, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka në dispozicion kodin burimor të “software”-it, i cili mbetet pronë e prodhuesit, ndërsa mënyra e licensimit dhe suportit teknik është e lidhur me politikat e vetë prodhuesit dhe marrëdhëniet që operatorët ekonomikë kane me të. Për këtë arsye, nuk është përcaktuar në dokumentacion një model i detajuar i licensimit apo numra specifikë licence.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë se mungesa e disa detajeve specifike teknike mund të krijojë paqartësi për operatorët ekonomikë në hartimin e ofertave të tyre, si dhe në funksion të garantimit të transparencës dhe barazisë në konkurrim, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishikimin dhe saktësimin e dokumentacionit përkatës. Pas përditësimit të Termave të Referencës dhe reflektimit të të gjitha elementeve të nevojshme teknike, procedura do të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f qëndron.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Aleksandër Harizi për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Njëpërmjet shkresës nr.230/11 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1164/1 prot., datë 04.05.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f. mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e softëareve të sistemit të parkimit” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kthimin e përgjigjes që autoritetit kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik ankimues mbi bazën e vendimit të KSHA-së që ka trajtuar këtë ankesë. Referuar kësaj shkrese rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj duke pranuar kriteret si më poshtë vijon:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në dokumentat standarte të tenderit, në pikën “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)” është përcaktuar “Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8: Shërbime për manaxhimin e vendeve të parkimit 98351000-8”.

KSHA gjykon se kodi i përcaktuar nga AK ka të bëjë me paketat software dhe sistemet e informacionit, dhe është vendosur duke patur në konsideratë objektin e procedurës së prokurimit, si dhe termat e referencës së saj. Përcaktimi i kodit nuk është një element që përjashton apo ndalon një operator ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, pasi çdo operator ekonomik i interesuar, është i lirë të jetë ofertues në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht kodit CPV, i cili është një element që nuk ndikon, apo penalizon asnjë operator ekonomik të interesuar për pjesëmarrje dhe për të dhënë ofertën e tij.

Referuar pikës 10, të nenit 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se: “Fjalori i përbashkët i prokurimit” është sistemi unik klasifikues i nomenklaturave të mallrave, shërbimeve dhe punëve që aplikohet në procedurat për prokurime publike dhe që siguron njetrajtshmëri me nomenklaturat ekzistuese për mallra, shërbime dhe punë”.

Megjithatë KSHA, në shqyrtim të pretendimin të operatorit ekonomik konstaton se kodet e përdorura në dokumentet e tenderit përfaqësojnë kategori të përgjithshme dhe aktivitete që lidhen pjesërisht me objektin e prokurimit, por nuk e reflektojnë plotësisht natyrën specifike të shërbimit që synohet të kontraktohet. Në këtë kuptim, pa e konsideruar këtë si një parregullsi thelbësore, vlerësohet se një përcaktim më i detajuar dhe më i përshtatshëm i kodeve FPP do të kontribuonte në një identifikim më të qartë të objektit dhe në lehtësimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë që ushtrojnë aktivitete në këtë fushë. Në përputhje të sa më sipër, dhe në funksion të përmirësimit të qartësisë dhe përputhshmërisë së dokumenteve të tenderit me kërkesat ligjore, autoriteti kontraktor do

të rishikojë kodet e përcaktuara dhe aty ku është e nevojshme, t'i përafrojë ato me kode më specifike të FPP që lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksander Harizi” p.f. qëndron..

- *Nisur nga mungesa e përcaktimit të qartë të dokumentit të kërkuar si dhe për të qenë më të qartë të gjithë palët e përfshira në një proces prokurimi si operatorët ekonomikë që përgatisin ofertat, Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave si dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (në rastin e ankesave për vlerësimin), autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit, duke përcaktuar qartë dokumentin që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbujten e pikës 2.3(6) të “Kapacitetit teknik”.*

Sa më lartë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në dokumentat standarte të tenderit, në Shtojcën 7, “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT” në pikën “Shërbimi që kërkohet” është përcaktuar “Mirëmbajtja e kanalizimeve, pusetave, pompave si më poshtë: ”.

Në shqyrtim të këtij pretendimi, KSHA gjykon se nga verifikimi i dokumenteve të tenderit konstatohet se në Shtojcën 7 është përfshirë formulimi “Mirëmbajtje e kanalizimeve. Pusetave, pompave si më poshtë”, i cili nuk lidhet me objektin konkret të prokurimit dhe nuk është në përputhje me natyrën e shërbimeve të kërkuara në këtë procedurë.

Në referim të nenit 36, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë dhe të saktë karakteristikat e shërbimeve që prokurohen, me qëllim shmangien e paqartësive dhe garantimin e një kuptimi të drejtë nga të gjithë operatorit ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, formulimi i sipërcituar vlerësohet si një pasaktësi e karakterit teknik-redaktues (lapsus), e cila nuk reflekton qëllimin real të autoritetit kontraktor dhe as objektin e procedurës.

Pa e konsideruar këtë si një devijim thelbësor të përmbajtjes së dokumenteve të tenderit, por për të qene të qartë dhe korrekt në hartimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit, ky formulim do të hiqet dhe do të korrigjohet në përputhje me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksander Harizi” p.f. qëndron.

- *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në Shtojcën 9, në Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 2.3.4 është përcaktuar: “2.3.4 Operatori ekonomik i interesuar duhet të paraqesë vërtetimin që software i përditësuar është i fiskalizuar në përputhje me Vendimin Nr.239, date 20.03.2020 “Për Kërkesat Teknike*

dhe Funksionale të Zgjidhjes Software-ike për Proçedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Proçedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit Nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit...” Gjithashtu në DST, në pikën 5.2 të Seksionit “Nioftimi i Kontratës; Autoriteti Kontraktor” është përcaktuar: “Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.”.

Si dhe, ne Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit është përcaktuar si vijon:

“Certifikimi i sistemit:

Sistemi fiskalizimit i ofruar nga operatori duhet të jetë, para fillimit të shërbimit:

- I certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe AKSHI si zgjidhje software-ike e fiskalizimit, në zbatim të VKM Nr. 239, datë 20.03 2020 dhe rregullores së përbashkët të certifikimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe AKSHI.
- I listuar në regjistrin zyrtar të subjekteve të certikuara të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në faqen zyrtare www.tatime.gov.al.

Tirana Parking sh.a. do të jetë përgjegjëse për marrjen dhe rinovimin në kohë të certifikatës elektronike nga AKSHI, nëpërmjet portalit e-Albania, e cila do të përdoret nga Sistemi i fiskalizimit për nënshkrimin dixhital të faturave. Certifikata elektronike është e lidhur në mënyrë unike me Tirana Parking sh.a. si entitet dhe mund të përdoret për të gjitha pikat e fiskalizimit të kompanisë. Operatori i shërbimit do të asistojë Tirana Parking sh.a. në procesin e konfigurimit të certifikatës në sistem ”.

Në shqyrtim të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit mbi software-in e fiskalizimit, konstatohet se në dokumentet e tenderit kjo është është trajtuar në disa seksione të ndryshme, konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, në informacionet shtesë, si dhe në shtojcën përkatëse mbi specifikimet teknike.

Referuar nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor ka detyrimin që kriteret e kualifikimit dhe kërkesat për dokumentacionin provues të përcaktohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe shteruese në dokumentet e tenderit, në mënyrë që operatorit ekonomik të kenë mundësi të kuptojnë detyrimet e tyre dhe të përgatisin ofertat në përputhje me këto kërkesa.

Në rastin konkret, kërkesa për një software të fiskalizuar në përputhje me Vendimin Nr.239, datë 20.03.2020 dhe ligjin Nr. 87/2019 është në vetvete e ligjshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 kërkon në

mënyrë të qartë që operatori ekonomik të vërtetojë se software-i është i fiskalizuar në përputhje me legjislacionin përkatës, ndërkohë që parashikimet e tjera në dokumentet e tenderit japin detaje shitesë mbi mënyrën e implementimit dhe përdorimit të këtij sistemi gjatë zbatimit të kontratës.

Përcaktimi në pikën 5.2 “Infomacione shitesë” në dokumentat standarde të tenderit, është pjesë përbërëse standarde në DST dhe autoriteti kontaktor nuk ka asnjë kompetencë për ta ndryshuar apo hequr. KSHA gjykon se përcaktimet e mësipërme nuk bien ndesh me njëra tjetrën për aq kohë sa kërkesat janë të iidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk cënojnë në thelb parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

Megjithatë mënyra e reflektimit të saj në tre seksione të ndryshme të dokumenteve të tenderit, me terminologji dhe nivele të ndryshme detajimi, mund të krijojë një situatë potencialisht konfuze për operatorët ekonomikë lidhur me natyrën dhe formën e dokumentacionit që duhet të paraqitet në fazën e ofertimit. Kjo mbivendosje nuk është një shkelje e dispozitave ligjore në thelb, por mund të kërkojë një strukturim më të qartë dhe koherent të kërkesave, në mënyrë që të shmangen interpretimet e ndryshme dhe të garantohet siguri juridike për pjesëmarrësit në procedurë.

Në këto kushte, dhe në funksion të rritjes së qartësisë, transparencës dhe lehtësimit të pjesëmarës në procedurë, KSHA vlerëson të arsyeshme rishikimin e dokumenteve të tenderit për të unifikuar dhe saktësuar kërkesat në fjalë, duke i përmbledhur ato në mënyrë të qartë në seksionin përkatës.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f. qëndron.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 8 të Dokumentave Standarde të Tenderit, është përcaktuar si vijon:

Konkretisht versionet e “**Lince**” të cilët janë instaluar në sistemet e parkimit si më poshtë:

12. Ish - Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë – (pranë “Asllan Rusi”)
13. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (pranë Kompleksit “Malajzian”)
14. Terminali i Autobuzave të Juglindjes – (pranë qendrës tregtare “TEG”)
15. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”)
16. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Pallati i Sportit “Asllan Rusi”)
17. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).
18. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Frederik Shopen”).
19. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).
20. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).
21. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).
22. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Bulevardi i Ri”)

12. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Kopshti Zoologjik”)

KSHA konstaston se, Autoriteti Kontraktor ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka konstatuar se pasaktësia e evidentuar lidhet vetëm me emërtimin e një pike parkimi në dokumentacion, ridërkohë që gjendja faktike në terren dhe numri i pikave funksionale të marra në konsideratë në përlllogaritje janë në përputhje me sa është parashikuar në DST. Konkretisht, numri i pikave të parkimit të konsideruara në përlllogaritjen e fondit limit është i saktë dhe i bazuar në situatën reale të ofrimit të shërbimit, pavarësisht pasaktësisë në emërtim, e cila nuk ndikon në përmbajtjen dhe shtrijen e objektit të kontratës.

Gjithashtu, në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor është bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat përcaktojnë se: “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysht kur përlllogarit vlerën e prokurimit.

2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit të këtij ligji, përveç se kur kjo justifikohet nga arsye objektive”.

Në zbatim të nenit 34 të ligjit, vlera e parashikuar e kontratës (fondi limit) përlllogaritet si një vlerë totale, e cila përfaqëson koston e plotë të shërbimit për të gjithë periudhën e kontratës, bazuar në analiza tregu, eksperiencë të mëparshme, si dhe në kërkesat konkrete të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Ky nen nuk detyron Autoritetin Kontraktor që për pdo rast të përcaktojë çmime për njësi për pdo element të ve antë të shërbimit, përveç rasteve kur vetë natyra e kontratës e kërkon një gjë të tillë.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 36 të ligjit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë objektin e kontratës dhe kërkesat funksionale të shërbimit, por nuk imponojnë detyrimin për ndarjen e fondit limit në mime për njësi, nëse kontrata është konceptuar si një shërbim i integruar.

Për rrjedhojë, në këtë procedurë përlllogaritja e fondit limit është kyer në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si një vlerë totale për realizimin e shërbimit në të gjitha pikat e parashikuara, dhe jo si mim për njësi për do pikë individuale. Kjo qasje është në përputhje me natyrën e kontratës dhe nuk cenon konkurrencën apo barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Megjithatë, duke qenë se pasaktësia në emërtim mund të krijojë paqartësi në interpretimin e dokumentacionit nga operatorët ekonomikë, dhe me qëllim garantimin e një procesi plotësisht transparent dhe të qartë për të gjithë pjesëmarrësit, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me anulimin e procedurës së prokurimit, për të mundësuar korrigjimin dhe saktësimin e dokumentacionit përkatës. Pas reflektimit të këtyre saktësimeve, procedura do të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f qëndron.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, mbi përmbajtjen e Shtojcës 8 “Termat e Referencës”, ju bëjmë me dije se, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në dokumentacion kërkesat funksionale dhe objektin e kontratës në mënyrë të përgjithshme, duke synuar sigurimin e një sistemi funksional, të përditësuar dhe të integrueshëm me infrastrukturën ekzistuese të parkimit.

Referimi ndaj versioneve të ndryshme të “software”-it Lince lidhet me faktin se sistemet aktuale janë instaluar në periudha të ndryshme dhe, për rrjedhojë, nuk paraqesin një standard të unifikuar versioni. Për këtë arsye, nuk është përcaktuar një version specifik (si p.sh. 7.0), por është lënë hapësirë që operatorit ekonomikë të propozojnë zgjidhje që përmbushin kërkesat për përditësim, siguri, performancë dhe integritet, në përputhje me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor.

Sa i takon lidhjes me serverin multiparking, kjo është një kërkesë funksionale që lidhet me nevojën për menaxhim të centralizuar të sistemeve të parkimit, dhe detajimi teknik i saj është pjesë e zgjidhjes që duhet të ofrohet nga operatori ekonomik në kuadër të realizimit të kontratës.

Në lidhje me licencat, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka në dispozicion kodin burimor të “software”-it, i cili mbetet pronë e prodhuesit, ndërsa mënyra e licensimit dhe suportit teknik është e lidhur me politikat e vetë prodhuesit dhe marrëdhëniet që operatorët ekonomikë kane me të. Për këtë arsye, nuk është përcaktuar në dokumentacion një model i detajuar i licensimit apo numra specifikë licence.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë se mungesa e disa detajeve specifike teknike mund të krijojë paqartësi për operatorët ekonomikë në hartimin e ofertave të tyre, si dhe në funksion të garantimit të transparencës dhe barazisë në konkurrim, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishikimin dhe saktësimin e dokumentacionit përkatës. Pas përditësimit të Termave të Referencës dhe reflektimit të të gjitha elementeve të nevojshme teknike, procedura do të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “Aleksandër Harizi” p.f qëndron.

Sa më lartë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët

kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4 Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5 Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të

ankesës së operatorit ekonomik Aleksandër Harizi, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.230/11 prot., datë 30.04.2026, të operatorit ekonomik Aleksandër Harizi

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Aleksandër Harizi, për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar që, *“Kërkesa për bilancet 2023, 2024 dhe 2025, e përcaktuar në pikën 2.2.2 të kriterëve të kualifikimit, duhet të hiqet”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në Shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” autoriteti kontraktor, ka parashikuar si më poshtë:

“2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. (Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).”

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik, i ndryshuar” parashikohet se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; d*
- h) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.2.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe 19 mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.2.5 Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës

III.2.6. Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave..[...]”

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, edhe kopje të certifikuara nga organet tatimore të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025). Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar”, legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të certifikuara, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Aleksandër Harizi, për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar modifikimin e kriterit 2.3.3 për specialistin i certifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE dhe specialistit të certifikuar për sistemet e parkimeve “AD.EL Srl duke përdorur termin “ekuivalent”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor, ka parashikuar si më poshtë:

“2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 1 (një) ose më shumë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si më poshtë, i cili të plotësojë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE”*
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimeve “AD.EL Srl”*
- 1 (një) specialist i certifikuar për konfigurime ne server*
- 1 (një) specialist i certifikuar për të administruar databaza*

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vëndi i origjinës, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.*
- CV e punonjësit.*
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.*

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm..

III.3.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4) b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4) b).

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose..”

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Duke qenë se objekt-prokurimi është një projekt i teknologjisë së informacionit dhe konkretisht sistemi i parkimit i sipërpërmendur nisur nga termit e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar ose/dhe të certifikuar në fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës”.

III.3.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.3.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka 5 detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.6. Neni 77 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, 2 dhe 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.7. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së mësipërme të lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të kriterëve. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, kriteret nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë lex specialis parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e kriterëve, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se kriteret duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 77 të LPP. Akoma më tej,

autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.3.9. Komisioni thekson se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriteret fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë lidhur me kriterin 2.3.3 si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse ky kriter është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis si dhe nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor përcaktimi i

kritereve kuafikuese, me qëllim garantimin e tij për përmbushjen me sukses të kontratës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoritetet kontraktore në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. K.P.P gjykon se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë lex specialis parashikon një përjashtim të tillë.

Nga verifikimet e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, në lidhje me kërkesën për 1 (një) specialist i çertifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE” dhe 1 (një) specialist i çertifikuar për sistemet e parkimeve “AD.EL” rezulton se certifikimet në fjalë kërkojnë vetëm nga prodhuesi i pajisjes. Komisioni thekson, se kriteret e kualifikimit lidhur me kualifikimet e stafit të operatorit ekonomik duhet të lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me një funksion konkret që parashikohet në specifikimet teknike dhe termat e referencës të kontratës që prokurohet. Sa më sipër, Komisioni e gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, me qëllim që të vërtetojë aftësitë e punonjësit bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të zotërojnë ky punonjës. Në rastet kur, bazuar në terma funksional, është e pamundur që të hartohet në mënyrë të qartë kriteri i kualifikimit, autoriteti kontraktor duhet të shtojë termin ekuivalent lidhur me llojin dhe nivelin e certifikimit.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në kuptim të hapjes së konkurrencës dhe gjithë përfshirjes, duhet të modifikojë kriterin duke shtuar termin ekuivalent mbi certifikimet e punonjësve pa cënuar funksionalitetin e shërbimit të kërkuar objekt prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit Aleksandër Harizi, se AK duhet të japi një informacion të saktë dhe e ka detyrim ligjor që të shpjegojë: Modelin e software-in Ad.El që ka

instaluar ne keto 15 (pesëmbëdhjete) pajisje parkometra.; Licensa e softëare te Parkometrave eshte e perhershme apo vjetore?; Mund te na jepet numri i licenses e instaluar tek parkometrat me qellim mundesimin e nje oferte ekonomike te favorshme per AK?; Kodi burim i licenses eshte prone e AK-se apo prodhesit? Ka pasur te instaluar sistem fiskal tek parkometrat?”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, kemi të bëjmë më shumë me kërkesa për sqarime për të cilat autoriteti kontraktor e ka sqaruar dhe nëpërmjet shkresës nr.230/12 prot, datë 30.04.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik Aleksandër harizi p.f për procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimi” me Nr, REF-81270-04-08-2026.

Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë paqartësi mbi kërkesat e autoritetit kontraktor dhe hartimin e ofertës teknike. Në nenin 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i 46 dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”,

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti këto sqarime duhet të publikohen në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesët e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik Aleksandër Harizi për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Aleksandër Harizi, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - (Shërbim)”, me nr. REF-81270-04-08-2026, me objekt “Mirëmbajtje e softwareve të sistemit të parkimit”, me fond limit 2,460,000 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues Aleksandër Harizi.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

